

V E N D I M
Nr. 611, datë 17.11.2000

**PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË PROCEDURËS “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË,
PËR NJË PAKETË MEDIKAMENTESH E MATERIALESH MJEKIMI, ME SHOQËRINË
FUFARMA, SH.A.**

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës dhe të nenit 17, të ligjit nr.7971, dtë 26.7.1995, “Për prokurimin publik”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe të ministrit të Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Lejimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor publik, që janë në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë, për të përdorur procedurën “prokurim i drejtpëdrejtë” me shoqërinë Fufarma, sh.a, për një paketë medikamentesh dhe materialesh mjekimi, sipas pasqyrës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë të ndjekë procedurat e negociimit me shoqërinë Fufarma, sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta

PASQYRA 1

1. Antibiotikë:

- a. Ampicilinë x 1 gr
- b) Amikacinë x 0.5 dhe 1 gr.
- c) Cefazolinë x 1 gr. Dhe 0.5 gr.
- d) Gentamicinë x 40 dhe 80 mgr.

2. Infuzione dhe solucione injektabël:

- a) Solucion glukoze 5%, 10% dhe 40%
- b) Solucion NaCl (Fiziologjik) 0.9% dhe 10%
- c) Solucion Ringer dhe Manitol
- d) Solucione të tjerë injektabël si Analginë, Ca Bromur, Ca Glukonat, Na Bikarbonat, Prozerinë, Adrenalinë, Furosemide dhe Oxitocinë.

3. Narkotikë dhe Psikotrope:

- a) Petidinë, Morphinë dhe Diazepam
- b) Fentanyl, Tiopental
- c) Halothame, Myorelaxinë
- d) Metadone

4. Materiale Mjekimi dhe Ndihmëse:

- a) Sisteme infuzioni dhe shiringa e dorëza kirurgjikale njëpërdorimshe
- b) Antidifterik, antirabies, antivipera, antitetanik

5. Lëndë të para farmaceutike

- a) Glukozë
- b) NaCL
- c) Laktozë
- d) Talk
- e) Alkool
- f. Manitol